

Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova /Government Of Kosova

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrasnjih Poslova / Ministry of  
Internal Affairs

---

Zyra e Koordinatorit Nacional - Sekretariati

Raporti i implementimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Menaxhimin e  
Integruar të Kufirit për vitin 2022

## Hyrje

Agjencitë e përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit që nga fillimi i implementimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit e deri më sot, kanë kaluar në disa faza të zhvillimit dhe avancimit të MIK-ut.

Sipas Ligjit për Kontrollin e Kufirit Shtetëror dhe Sipas Ligjit për Bashkëpunim në mes të Autoriteteve të Përfshira në MIK, agjencitë kryesore të përfshira në MIK janë Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës dhe Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës. MIK-u koordinohet nga Ministria e Punëve të Brendshme përmes Koordinatorit Nacional, i cili emërohet nga Kryeministri. Koordinatori Nacional njëherit është edhe udhëheqës i Bordit Ekzekutiv të MIK-ut në të cilin bëjnë pjesë Drejtori i Policisë Kufitare, Drejtori i Përgjithshëm i Doganës dhe Kryeshefi i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës.

*Ky raport përbën një përmbledhje të hollësishme të aktiviteteve dhe veprimeve të ndërmarra brenda vitit 2022 nga tri agjencitë kryesore të përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit, siç janë të parapara me Strategjinë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit.*

Ministria e Brendshme si Koordinatorë në bashkëpunim me tri agjencitë, ka vendosur si prioritet avancimin dhe zhvillimin e MIK-ut në Pikë Kalimet Kufitare, duke marrë parasysh rëndësinë që ka MIK-u në procesin Liberalizimit të Vizave dhe MSA.

Gjatë kësaj periudhe raportuese Bordi Ekzekutiv për MIK, ka mbajtur tre (3) takime ku janë marrë vendime lidhur me Bashkëpunimin Ndërmjet Agjencive, avancimin e QKMK-së dhe vlerësimin e zbatimit të Strategjisë së MIK-ut.

## **PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE**

Strategjia Shtetërore për Menaxhimin e Integruar të kufirit është dokument i cili prezanton situatën e përgjithshme, mekanizmat institucional, dobësitë e tanishme, parimet themelore dhe është hartuar në pajtim me udhëzuesit e bashkimit evropian për Menaxhimin e Integruar të Kufirit.

Qëllimi i kësaj strategjie është zhvillimi i mëtejshëm i politikave për marrjen e përgjegjësisë për mbrojtjen e individit dhe shoqërisë, duke ndërtuar mekanizmat e nevojshëm në pajtim me standardet ndërkombëtare për kontrollin e kufirit shtetëror.

Strategjia Shtetërore për Menaxhimin e Integruar të Kufirit dhe Plani i Veprimit 2020-2023, është hartuar në mbështetje të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Ky dokument është i ndarë në tri shtylla bashkëpunimi brenda Autoritetit, bashkëpunimi Ndërmjet Autoriteteve dhe bashkëpunimi Ndërkombëtar. Secila shtyllë është e përbërë nga parametrat si në vijim: Korniza Ligjore, Organizimi dhe Menaxhimi, Komunikimi dhe Shkëmbimi i Informacionit, Infrastruktura dhe Pajisjet.

## **PROGRESI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE BAZUAR NË TRI SHTYLLAT E MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË KUFIRIT**

Gjatë vitit 2022 ka progres në zbatimin e aktiviteteve që rrjedhin nga tri shtyllat e MIK-ut, në të gjitha parametrat përfshirë kornizën ligjore, komunikimin, teknologjinë informative, infrastrukturën dhe pajisjet e trajnimit.

Shtylla e parë, te bashkëpunimi brenda autoritetit, ka progres më të theksuar te parametri korniza ligjore, si dhe te organizimi dhe menaxhimi.

Te shtylla e dytë, te bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve, kemi progres të theksuar në të gjitha parametrat, sidomos progresi theksohet teknologjia informative, procedurat, organizimi dhe menaxhimi, si dhe komunikimi.

Në shtyllën e tretë, te bashkëpunimi ndërkombëtar, ka ngecje në zbatimin e disa aktiviteteve. Këto ngecje kanë të bëjnë me vullnetin e shteteve tjera.

## **PROGRESI KUNDREJT SHTYLLAVE**

### **Bashkëpunimi Brenda Autoritetit**

#### **Korniza Ligjore**

Te korniza Ligjore, është në proces Plotësim ndryshimi i Ligjit për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror. Miratimi i këtij ligji do të ketë pasojë edhe ndryshimin gjegjësisht rishqyrtimin e legjislacionit sekondar, përfshirë Procedurat Standarde të Operimit. Infrastruktura ligjore është objektiv në vazhdimësi.

#### **Organizimi dhe Menaxhimi**

Autoritet e përfshira në MIK, PK, DK, AUV kanë rishikuar strukturat organizative të tyre duke përfshirë në kuadër të strukturës së tyre sektorin e MIK-ut. Rivendosja e sektorëve të MIK-ut do të ndikoj direkt në përsheptimin e realizimit të proceseve në MIK.

#### **Trajnimit**

Gjatë vitit 2022 janë realizuar një numër i madh i trajnimeve nga autoritet e MIK-ut veç e veç.

#### **Teknologjia Informative**

PK ka vazhduar me mirëmbajtjen dhe avancimin e sistemit BMS në të gjitha Pikat e Kalimit Kufitar.

Në AUV, është përzgjedh operatori për programin elektronik (FCMS) ku do të bëhet unifikimi

i të gjitha inspektimeve dhe laboratorëve në një sistem elektronik.

Dogana e Kosovë ka vazhduar me mirëmbajtjen dhe avancimin e sistemit ASICUDA.

### **Infrastruktura dhe Pajisjet**

Gjatë vitit 2021-2022 Policia Kufitare është pajisur me: 22 kamera termike, 28 kompjuterë, 20 telefona të mençur. Ndërsa nga donatorët e ndryshëm është pajisur me dylbi të ndryshme, bateri ndriçuese rimbushëse, detektorë dore dhe pajisje për kontroll të automjeteve, 26 tabletë dhe 30 pajisje për regjistrimin e gishtërinjve, endoskop dhe pajisje tjera elektronike, 30 kompjuterë me pajisje përcjellëse, 2 llap top, 27 çanta me ndihmë të parë, pajisje të ndryshme dhe fibër optika.

### **Vlerësim i Përgjithshëm**

Pothuajse të gjitha aktivitetet në shtyllën e parë, janë në vazhdimësi, dhe mund të konkullojnë se për vitin 2022 ka progres të plotë në zbatimin e këtij objekti. Sa i përket këtij objekti strategjik i cili nënkupton ngritjen e bashkëpunimit brenda autoriteteve, sipas vlerësimit të veprimeve të ndërmarra plotësisht janë implementuar 16.66 %, pjesërisht 77.77 %, nuk janë realizuar sipas planit 5.55 %.

## **Bashkëpunimi ndërmjet Autoriteteve**

### **Korniza Ligjore**

Është hartuar PSO për funksionimin e API-PNR. Kjo PSO do të rregullon sjellën e tri agjencive që veprojnë në njësinë e themeluar për API-PNR në kuadër të QKMK-së.

### **Organizimi dhe Menaxhimi**

Në kuadër të QKMK-së është funksionalizuar plotësisht Njësia për API, ndërsa është në proces të funksionalizimit njësia për PNR. Për funksionalizimin e PNR-së, është e nevojshme arritja e marrëveshjeve me shtetet e BE-së.

Nuk ka progres në krijimin e linjës buxhetore për menaxhimin e integruar të kufirit gjegjësisht për shtyllën e dytë të MIK-ut.

Gjatë vitit 2022 është funksionalizuar API ku është plotësuar me staf, shefi i NJIP tog i PK-së, 4 zyrtarë nga PK dhe 2 nga DK, ndërsa në Dhomën Operative QKMK kemi mungesë dy togerë, dy zyrtarë policor dhe katër zyrtarë të AUV, si dhe tek NJPIARK një zyrtar të DK-së.

### **Trajnimet**

Gjatë vitit 2022 janë organizuar trajnime të avancuara për zyrtarët e njësisë për API-PNR. Po ashtu, janë mbajtur trajnime të specializuara, punëtori dhe vizita studimore për zyrtarët e Njësisë së NJIP( API-PNR) dhe të NJPIARK-së në kuadër të QKMK-së, gjithsej 10 aktivitete trajnuese.

### **Procedurat**

Gjatë vitit 2022 ka pasur rritje të numrit të operacioneve të përbashkëta, janë realizuar 8 operacione të përbashkëta ndërmjet autoriteteve të MIK-ut.

### **Komunikimi dhe Shkëmbimi i Informacionit**

Pas funksionalizimit të API(NJIP), po pranojmë të dhëna IPU(API)100% nga operatorët e transportit ajror, ndërsa lidhur me REU(PNR) nga tre operatorë dhe procesi po vazhdon.

### **Infrastruktura dhe Pajisjet**

Sa i përket pikës raportuese nga DK janë iniciuar këto veprime në kuadër të projektit " Rregullimi i PKK-ve në kuadër të MIK-ut":

- Projekti për renovimin e objektit për kontrollin e vijës së dytë në PPKK Morinë-Vërmicë;
- Projekti për rregullim të ndriçimit dhe mirëmbajtje të objektit në PPKK Hani i Elezit dhe PPK Gllloboqicë, dhe
- Projekti për kryerjen e aktiviteteve punuese në rregullimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të punës në PPK Bërnjak.

### **Vlerësim i përgjithshëm**

Bashkëpunimi Ndërmjet Autoriteteve është shtylla me e rëndësishme e Menaxhimit të Integruar

të Kufirit. Gjatë këtij viti tri autoritetet e MIK-ut, janë angazhuar maksimalisht për ngritjen e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve duke ndikuar direkt në luftimin e krimit ndërkufitar. Sa i përket këtij objektivi strategjik, sipas vlerësimit të aktiviteve, plotësisht janë implementuar 50%, pjesërisht 30.76%, nuk janë realizuar sipas planit 19.23% .

### **Bashkëpunimi Ndërkombëtar**

#### **Korniza Ligjore**

Është nënshkruar marrëveshja me Republikën e Shqipërisë për trafikun lokal dhe e njëjta është duke u zbatuar.

#### **Organizimi dhe Menaxhimi**

Është bërë kategorizimi i PKK Krushevc –Shishtavec nga kategoria C në B.

#### **Vlerësim i përgjithshëm**

Te shtylla e tretë Bashkëpunimi Ndërkombëtar në përgjithësi ka ngecje dhe është pasojë e mos vullnetit të shteteve tjera, pavarësisht se ka iniciativa të vazhdueshme nga ana e autoriteteve kufitare. Sa i përket këtij objektivi strategjik, sipas vlerësimit të aktiviteve plotësisht janë implementuar, pjesërisht janë zbatuar 20 %, nuk janë realizuar sipas planit 80%.

### **RREZIQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE**

Marrë parasysh aktivitetet e parapara në Plan të Veprimit, konsiderojmë se ka pengesa procedurale në shtyllën e parë të MIK-ut dhe në shtyllën e dytë, ndërsa sa i përket bashkëpunimit ndërkombëtarë ka pengesa në zbatim ngase për realizmin e aktiviteve varet edhe vullneti i palës tjetër.

Sfidë reale është i integrimi i sistemeve me të dhëna të gjitha agjencitë dhe shfrytëzimi i përbashkët i një sistemi unik për regjistrimin e hyrje-daljeve. Krijimi, gjegjësisht ndërtimi i kësaj data-baze është shumë i kushtueshëm.

Përfundimi i demarkacionit të Kufirit me R. e Serbisë është sfidë në vete.

Anëtarësimi në Organizatat Ndërkombëtare, është një sfidë dhe tri autoritete po bëjnë përpjekje të vazhdueshme që të bëhen pjesë e të gjitha organizatave ndërkombëtare, qofshin ato policore ose doganore.

## Raporti i monitorimit të Planit të Veprimit për vitin 2022 - Modeli për progresin kundrejt veprimeve

Fokusi i raportit të planit të veprimit është në përfundimin e veprimeve siç parashihet në planin e veprimit dhe arsyet e vonesave, të cilat jepen në shtyllën "Progresi në zbatim".

Nr.	Objektivat dhe veprimet	Afati i fundit	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca në dokumente	Progresi në zbatim
<b>I.</b>	<b>Objektivi strategjik</b>						
<b>I.1</b>	<b>Objektivi specifik</b>	Përditësimi i vazhdueshëm dhe rishikimi i akteve ligjore dhe nënligjore për sigurinë kufitare në përputhje me kërkesat e “Acquis Communautaire të BE-së”					
I.1.1.1	Plotësim ndryshimi i ligjeve që ndërliken me kontroll kufitar.	2020-2022	Buxheti i Kosovës	MPB, PK, DK, AUV	Ligji për Kontroll Kufitar i plotësuar dhe ndryshuar. Legjislacioni sekondar i ndryshuar në harmoni me ndryshimin e Ligjit.		Ligji për Kontroll Kufitar është në proces të miratimit në Qeveri. Legjislacioni sekondar do të ndryshohet pas miratimit të Ligjit nga Kuvendi i R. Kosovës.
I.1.1.2	[Titulli i veprimit]						
I.1.1.3	[Titulli i veprimit]						
<b>I.2</b>	<b>Objektivi specifik</b>	Rishikimi i strukturave organizative të autoriteteve të MIK-ut					
II.1.1.1	Analizimi, vlerësimi dhe përshtatja e strukturës organizative për funksionim të MIK-ut.	2021-2022	Buxheti i R. së Kosovës	PK, DK, AUV	Raport mbi vlerësimin e funksionimit të strukturave në funksion të MIK-ut.	Ligji për Bashkëpunim ndërmjet Autoriteteve të MIK-ut, Strategjia për MIK.	Tri agjencitë kanë bërë vlerësimin e strukturave dhe janë në proces të riorganizimit.
II.1.1.2	[Titulli i veprimit]						
<b>II.</b>	<b>Objektivi</b>						

	<b>strategjik:</b>						
<b>II.1</b>	<b>Objektivi specifik</b>	Rishikimi i Procedurave standarde te operimit për kontrolle kufitare					
I.1.1.2	Hartimi dhe plotësim -ndryshimi i procedurave standarde të operimit.	Në vazhdimësi	BK	MPB, PK,DK,AUV	PSO-të e hartuara dhe të ndryshuara.	Ligji për Bashkëpunim, Strategjia e MIK-ut.	Është hartuar PSO për API-PNR dhe është në proces të miratimit në Bordin Ekzekutiv për MIK. Nuk ka pengesa në zbatim të këtij objekti.
<b>II.</b>	<b>Objektivi strategjik:</b>						
<b>II.1</b>	<b>Objektivi specifik</b>	Hartimi i kriterëve, përzgjedhja dhe trajnimi i personelit që punojnë në kufi					
II.1.1.2	Trajnimi të avancuara dhe specializuara.	2021-2022	BK dhe donator	MPB, QKMK	Trajnimet e realizuara		Janë mbajtur trajnime të specializuara për zyrtarët e Njesisë për API-PNR në kuadër të QKMK-së.
<b>Objektivi strategjik:</b>							
<b>Objektivi specifik</b>		Avancimi i sistemit të teknologjisë informative dhe komunikimit për shkëmbimin e informacioneve					
II.1.1.2	Avancimi i sistemit për Menaxhimin Kufitar i	2021-2022	BK	PK	Sistemi i avancuar	Ligji për Bashkëpunim	Në vazhdimësi bëhet mirëmbajtja e sistemit BMS(SMK).
<b>Objektivi strategjik:</b>							
<b>Objektivi specifik</b>		Avancimi i infrastrukturës kufitare dhe sigurimi i pajisjeve të avancuara dhe të specializuara					
II.1.1.2	Sigurimi i pajisjeve	2021-2022	BK,	MPB, PK	Pajisjet e		Gjatë vitit 2021-

	të specializuara për Policinë Kufitare.		donacion		siguruara		2022 Policia Kufitare është pajisur me: 22 kamera termike, 28 kompjuterë, 20 telefona të mençur. Ndërsa nga donatorët të ndryshëm është pajisur me dylbi të ndryshme, bateri ndriçuese rimbushëse, detektorë dore dhe pajisje për kontroll të automjeteve, 26 tabletë dhe 30 pajisje për regjistrimin e gishtërinjve, endoskop dhe pajisje tjera elektronike, 30 kompjuterë me pajisje përcjellëse, 2 llap top, 27 çanta me ndihmë të parë, pajisje të ndryshme dhe fibër optika.
--	---	--	----------	--	-----------	--	---



II.1.1.3							
<b>Objektivi strategjik:</b>	<b>Bashkëpunimi Ndërmjet Autoriteteve</b>						
<b>Objektivi specifik</b>	Rishikimi i akteve ligjore, nënligjore dhe dokumenteve tjera për sigurinë kufitare në përputhje me kërkesat e “Acquis Communautaire të BE-së”						
II.1.1.3	Hartimi i UA për API- PNR sipas rregullore të BE-së.	2021-2022	BK	PK,DKAUV	UD i miratuar	Ligji për Kontroll dhe Mbikëqyrjen e Kufirit.	E përfunduar.
<b>Objektivi specifik</b>	<b>Organizimi dhe menaxhimi</b>						
II.1.1.3	Luftimi i aktiviteteve kriminale dhe veprave që ndërlihen me terrorizëm në kufi të RKS-së.	2021-2023	BK	PK,DK,AUV	Numri i aktiviteteve kriminale të luftuara gjatë 2022		Nuk ka progres.
	Sigurimi i linjës të veçantë buxhetore për MIK në kuadër të MPB-së.	2021-2023	BK	MPB	Linja buxhetore e siguruar	Strategjia për MIK	Nuk ka progres, ka pengesa procedurale.
	Hetime të përbashkëta për luftimin e aktiviteteve të kundërligjshme në baze të analizës së riskut.	2021-2023	BK	PK,DK,AUV	Numri i hetimeve të përbashkëta për luftimin e aktiviteteve të kundërligjshme në bazë të analizës së riskut.		Nuk ka progres.
<b>Objektivi specifik</b>	Rishikimi i Procedurave Standarde të Operimit (PSO) për kontroll kufitar në përputhje me aktet ligjore dhe Rregulloret e BE-së						
	Planifikimi dhe rritja e operacioneve të	2021-2023	BK	MPB	Numri i operacioneve të	Strategjia për MIK	Në proces

	përbashkëta ndërmjet autoriteteve të MIK ut.				përbashkëta ndërmjet autoriteteve të kufirit për vitin 2022.		
<b>Objektivi specifik</b>		Plotësimi me staf dhe organizimi i trajnimeve të vazhdueshme ndërmjet autoriteteve dhe me akterët tjerë me fushëveprim në kufi					
	Ngritja e kapaciteteve njerëzore në QKMK.	2021-2022	BK	PK,DK,AUV	Kapacitete e ngritura me nr. e zyrtarëve të dërguar në QKMK.	Strategjia e MIK-ut, Plani Veprimit gjashtë pikësh i QKMK.	Gjatë vitit 2022, është funksionalizuar NJIP ku është plotësuar me staf, shefi i NJIP tog i PK-së, 4 zyrtarë nga PK dhe 2 nga DK ndërsa në Dhomën Operative QKMK kemi mungesë dy togerë, dy zyrtarë policor dhe katër zyrtar të AUV, si dhe te NJPIARK një zyrtar të DK-së.
	Realizimi i trajnimeve të avancuara dhe të specializuara për personelin në	2021-2022	BK, donatorët	MPB,PK,DK,AUV	Numri i trajnimeve të avancuara për personelin e QKMK.	Strategjia e MIK-ut, Plani Veprimit gjashtë pikësh i QKMK.	

	QKMK.						
<b>Objektivi specifik</b>	Përmirësimi i komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet autoriteteve kufitare, vendosja dhe avancimi i sistemeve teknologjisë së informacionit						
	Zhvillimi i sistemimeve për paralajmërim të hershëm të pasagjerëve (API) dhe regjistrimit të emrave të pasagjerëve PNR.	2021-2022	BK, donatorët	MPB,PK,DK,AUV	Sistemi i zhvilluar për paralajmërim të hershëm të pasagjerëve.	Strategjia e MIK-ut, Plani Veprimit gjashtë pikësh i QKMK.	Pas funksionalizmit të API(NJIP), në vazhdimësi po pranojmë të dhëna IPU(API)100% nga operatorët e transportit ajror, ndërsa lidhur me REU(PNR) nga tre operatorë dhe procesi po vazhdon.
<b>Objektivi specifik</b>	Zhvillimi i infrastrukturës të PKK-ve dhe sigurimi i pajisjeve të nevojshme për autoritetet kufitare						
	Renovimi i objekteve në PKK Hani i Elezit, Qafë Prush, Qafë Morinë.	2021-2022	BK, donatorët	MPB,PK,DK,AUV	PKK e rinovuar	Strategjia e MIK-ut, Plani Veprimit gjashtë pikësh i QKMK.	Sa i përket pikës raportuese nga DK janë iniciuar këto veprime në kuadër të projektit " Rregullimi i PKK-ve në kuadër të MIK-ut": - Projekti për renovimin e objektit për kontrollin e vijës

							<p>së dytë në PPKK Morinë-Vërmicë</p> <p>'</p> <p>- Projekti për rregullim të ndriçimit dhe mirëmbajtje të objektit në PKK Hani i Elezit dhe PKK Gilloboqicë dhe</p> <p>- Projekti për kryerjen e aktiviteteve punuese në rregullimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të punës në PKK Bërnjak.</p>
<b>Objektivi strategjik:</b>	<b>Bashkëpunimi Ndërkombëtar</b>						
<b>Objektivi specifik</b>	Zbatimi i marrëveshjeve ekzistuese dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit me vendet tjera						
Arritja e marrëveshjeve ndërkombëtare, memorandumeve të mirëkuptimit dhe protokolleve në fushën e MIK-ut me vendet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare.	2021-2023	BK, donatorët	MPB,PK,DK,AUV	Marrëveshjet dhe protokollet e nënshkuara	Strategjia e MIK-ut, Plani Veprimit gjashtë pikësh i QKMK.	Është nënshkruar marrëveshja me R. e Shqipërisë për trafikun lokal dhe e njëjta është duke u zbatuar.	

<b>Objektivi specifik</b>	Të përmirësohet bashkëpunimi ndërkombëtar dhe shkëmbimi i informatave duke përfshirë avancimin e mëtutjeshëm të bashkëpunimit ndërkufitarë me vendet fqinjë					
Hapja e pikave të përbashkëta të kalimit kufitare.	2021-2023	BK, donatorët	MPB,PK,DK,AUV	Pikat e përbashkëta të funksionalizuara.	Strategjia e MIK-ut, Plani Veprimit gjashtë pikësh i QKMK.	Është bërë kategorizimi i PKK Krushevc – Shishtavec nga kategoria C në B.
<b>Objektivi specifik</b>	Avancimi i komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit me vendet tjera dhe vendosja e një sistemi të menaxhimit të informacionit					
Vendosja e linjës së komunikimit të drejtpërdrejtë me vendet fqinje dhe më gjerë përmes shkëmbimit të raporteve, informatave, përpilimit të analizave të përbashkëta të riskut, hetimeve të përbashkëta.	2021-2023	BK, donatorët	MPB,PK,DK,AUV	Linjat e vendosura me shtete fqinje.	Strategjia e MIK-ut, Plani Veprimit gjashtë pikësh i QKMK.	Nuk ka pas progres.
Intensifikimi i përpjekjeve për anëtarësim të plotë në organizatat ndërkombëtare.	2021-2023	BK, donatorët	MPB,PK,DK,AUV	Numri i marrëveshjeve të iniciuara.	Strategjia e MIK-ut, Plani Veprimit, Ligji për bashkëpunim Ndërmjet autoriteteve të përfshira në MIK.	Në vazhdimësi ka përpjekje nga ana e tri Autoriteteve për anëtarësim në organizata ndërkombëtare.
<b>Objektivi specifik</b>	Ndërtimi i objekteve funksionale të përbashkëta me të gjitha vendet fqinje					
Ndërtimi i PKK-të të	2021-2023	BK,	MPB,PK,DK,AUV	PKK-t e	Strategjia e	Nuk ka pasur progres.

përbashkëta dhe të pajisen me infrastrukturë përcjellëse.		donatorët		përbashkëta të ndërtuara	MIK-ut, Plani Veprimit, Ligji për bashkëpunim Ndërmjet autoriteteve të përfshira në MIK.	
---	--	-----------	--	--------------------------	--	--